

VENDIM
Nr. 878, datë 12.12.2012

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR PËR
PROCEDURËN E PROKURIMIT PUBLIK, ME OBJEKT “RRJETI I KOMUNIKIMEVE ON-
LINE I SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE”, TË KRYER NGA MINISTRIA E BRENDSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Brendshme, si organ qendror blerës, të realizojë, brenda datës 31 dhjetor 2012, procedurën e prokurimit, me objekt “Rrjeti i komunikimeve *on-line* i shërbimit të Gjendjes Civile”, me fondet e miratuara në buxhetin e këtij viti, të përcaktuara në aneksin bashkëlidhur këtij vendimi.

Brenda këtij afati të përfshihet publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinën e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor i përmendur në aneks për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha